VENDIM
Nr.334, datë 1.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.17, DATË 13.1.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E AFATEVE TË PËRDORIMIT TË ARMËVE, TË TEKNIKËS E TË PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË RREGULLAVE PËR TRAJTIMIN E TYRE, PAS HEQJES NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 7 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr.17, datë 13.1.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Armët, mjetet dhe pajisjet e Forcave të Armatosura hiqen nga përdorimi me urdhër të autoritetit përkatës, sipas pikës 5 të këtij vendimi, kur:

a) janë plotësuar vitet e përdorimit, sipas tabelave nr.1 e nr.2;

b) janë plotësuar kilometrat e përshkruar, sipas tabelës nr.1;

c) janë plotësuar orët e punës, sipas tabelës nr.1;

ç) është plotësuar numri i të shtënave, sipas tabelës nr.2;

d) janë tepër dhe jashtë nevojave të Forcave të Armatosura, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve (TOP);

dh) janë të papërdorshme, si rezultat i dëmtimit të elementeve fizike e kimike ose e humbjes së vetive tekniko-luftarake."

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha